



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA ROSKOVEC
DREJTORIA E SHËRBIMEVE SOCIALE DHE KULTURORE

Nr. 527 prot

Roskovec , më 23.01 .2025

PROJEKT-VENDIM

Nr. 2 datë 23/01/2025

**PËR DHËNIEN E NDIHMËS EKONOMIKE NGA FONDI I KUSHTËZUAR DERI 6%
PËR PERIUdhËN 1-31 DHJETOR 2024**

Në mbështetje të nenit 21 të Ligjit nr. 57/2019, "Për Asistencën Sociale në Republikën e Shqipërisë", në pikën 2, 3, 6, 9, dhe 10 të Kreut IV të Vendimit nr. 597, datë 04.09.2019 "Për përcaktimin e procedurave, të dokumentacionit dhe masës mujore të përfitimit të ndihmës ekonomike dhe përdorimit të fondit shtesë mbi fondin e kushtëzuar për ndihmën ekonomike", Vendimit të Këshillit të Bashkisë nr.3, date 30.01.2024, "Për miratimin e kritereve për familjet në nevojë që do të trajtohen me ndihmë ekonomike, nga fondi i kushtëzuar deri 6% për bllok-ndihmën për vitin 2024", administratorët e seksionit të ndihmës sociale i propozojmë Këshillit të Bashkisë Roskovec gjatë muajit Dhjetor 2024, për sa më poshtë:

Përfitojnë ndihmë ekonomike nga fondi i kushtëzuar deri 6% për muajin **Dhjetor 2024**, në total **9 (nëntë)** familje me fond total prej **37990 (tridhjet e shtatë mijë e nëntëqind e nëntëdhjet)** lekë. Konkretisht:

PËR BANORËT E QENDRËS SË BASHKISË ROSKOVEC

Përfitojnë ndihmë ekonomike nga fondi i kushtëzuar deri 6% për muajin Dhjetor 2024, **2 (dy)** familje me një fond **7406 (shtatë mijë katërqind e gjashtë)** lekë.

PËR BANORËT E NJESISË ADMINISTRATIVE STRUM

Përfitojnë ndihmë ekonomike nga fondi i kushtëzuar deri 6% për muajin Dhjetor 2024, **2 (dy)** familje me një fond **8373(tetë mijë e tre qind e shtatëdhjet e tre)** lekë.

PËR BANORËT E NJËSISË ADMINISTRATIVE KUMAN

Përfitojnë ndihmë ekonomike nga fondi i kushtëzuar deri 6% për muajin Dhjetor 2024, 3 (tre) familje me një fond 13345 (trembëdhjet mijë e treqind e dyzet e pesë) lekë.

PËR BANORËT E NJËSISË ADMINISTRATIVE KURJAN

Përfitojnë ndihmë ekonomike nga fondi i kushtëzuar deri 6% për muajin Dhjetor 2024, 2 (dy) familje me një fond 8866 (tetë mijë e tetëqind e gjashtëdhjet e gjashtë) lekë.

Pas miratimit nga Këshilli i Bashkisë Roskovec, ngarkohet sektori i Financës dhe sektori i Shërbimit Social për ekzekutimin e këtij vendimi.

Konceptoi. *S.Saliaj*

Miratoi. *S.Çepele*

Konfirmoi. *D.Hoxha*

Për Drejtorinë e Burimeve Njerëzore dhe Çështjeve Juridike . *V.Zeqo*

KRYETAR

Majlinda BUFI

Bashkia Roskovec
Dhjetor 2024

FAMILJET QË DO TË TRAJTOHEN ME NDIHMË EKONOMIKE NGA FONDI I KUSHTËZUAR DERI NË 6%.

Nr	Emer Atesi Mbiemer	Nr. dosje	Nr. Frymeve	Lloji i ndihmës	Shuma
1	Marjeta Sami Qosja		2	Familje në nevojë	3703
2	Zhaneta Ferrik Hatillari		2	Familje në nevojë	3703
	Shuma				7406

Mbyllet me nr rendor 2(dy)

P.Z.Ndihmës Ekonomike
Sonila Rrapushi


KRYETAR
Majlinda Buri



Njësia Administrative Strum
Dhjetor 2024

FAMILJET QË DO TË TRAJTOHEN ME NDIHMË EKONOMIKE NGA FONDI I KUSHTËZUAR DERI NË 6%.

Nr	Emër Ateshi Mbiemer	Nr.dosjes	Nr.Frymëve	Lloji i ndihmës ndihmes	Shuma
1	Nexhmije Ali Hazizi	NE-2023-005472	1	Familje në nevojë	3146
2	Almet Hidajet Gjyla	NE-2021-034311	3	Familje në nevojë	5227
	SHUMA				8373

Mbyllet me nr. rendor 2(dy)

Sp.Z.Ndihmes Ekonomike
Romeida Cjapi

KRYETAR
Majlinda Bufi



Njësia Administrative Kuman
Dhjetor 2024

FAMILJET QË DO TË TRAJTOHEN ME NDIHMË EKONOMIKE NGA FONDI I KUSHTËZUAR DERI NË 6%.

Nr	Emer Ates Mbiemer	Nr.dosjes	Nr.Frymeve	Lloji i ndihmës ndihmes	Shuma
1	Anxhela Rrapi Shurdha		2	Familje në nevojë	5940
2	Aishe Jonus Akulli		1	Familje në nevojë	2178
3	Aleksandër Ramis Dalipaj		3	Familje në nevojë	5227
3	Shuma		6		13345

Mbyllet me nr rendor 3 (tre)

P/Shërbimit Social
Sidorela Saliaj

KRYETAR
Majlinda BUFI



Njësia Administrative Kurjan
Dhjetor 2024

FAMILJET QË DO TË TRAJTOHEN ME NDIHMË EKONOMIKE NGA FONDI I KUSHTËZUAR DERI NË 6%.


Nr	Emer Ateshi Mbiemer	Nr.dosjes	Nr.Frymeve	Lloji i ndihmës	Shuma
1	Ramadan Gani Koronaj		1	Familje në nevojë	5720
2	Donika Hysni Lika		1	Familje në nevojë	3146
	Shuma				8866

Mbyllet me nr rendor 2 (dy)

P.Z.Ndihmës Ekonomike
Erida Toro



KRYETAR
Majlinda Bufi





REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA ROSKOVEC
DREJTORIA E SHËRBIMEVE SOCIALE DHE KULTURORE

Nr. 5271 prot
11

Roskovec , më 23.01.2025

Relacion: Për miratimin e familjeve në nevojë që do të trajtohen me ndihmë ekonomike, nga fondi i kushtëzuar deri 6% për muajin Dhjetor 2024

KËSHILLIT TË BASHKISË

Roskovec

Të nderuar Këshilltarë!

Në mbështetje të nenit 21 të Ligjit nr. 57/2019, “Për Asistencën Sociale në Republikën e Shqipërisë”, në pikën 2, 3, 6, 9, dhe 10 të Kreut IV të Vendimit nr. 597, datë 04.09.2019 “Për përcaktimin e procedurave, të dokumentacionit dhe masës mujore të përfitimit të ndihmës ekonomike dhe përdorimit të fondit shtesë mbi fondin e kushtëzuar për ndihmën ekonomike”, Vendimit të Këshillit të Bashkisë nr.3, datë 30.01.2024,”Për miratimin e kriterëve për familjet në nevojë që do të trajtohen me ndihmë ekonomike, nga fondi i kushtëzuar deri 6% për bllok-ndihmën për vitin 2024”.

Spektori i ndihmës ekonomike ju paraqet për diskutim dhe miratim Projekt-Vendimin “Për miratimin e familjeve në nevojë që do të trajtohen me ndihmë ekonomike, nga fondi i kushtëzuar deri 6% për muajin Dhjetor 2024” Në këtë muaj janë përzgjedhur për tu trajtuar 9 (nëntë) familje me fond 37990 (tridhjet e shtatë mijë e nëntëqind e nëntëdhjet) lekë, konkretisht 2 (dy) familje në Njësinë Roskovec, 2 (dy) familje në Njësinë Administrative Strum, 3(tre) familje në Njesinë Administrative Kuman dhe 2(dy) familje në Njesinë Administrative Kurjan. Listat emërore të familjeve dhe fondin që merr çdo familje i gjeni bashkëngjitur Projekt-Vendimit të muajit Dhjetor 2024.

Këto familje janë përzgjedhur duke u bazuar në nenin 21 të Ligjit nr. 57/2019, “Për Asistencën Sociale në Republikën e Shqipërisë”, në pikën 2, 3, 6, 9, dhe 10 të Kreut IV të Vendimit nr. 597, datë 04.09.2019 “Për përcaktimin e procedurave, të dokumentacionit dhe masës mujore të përfitimit të ndihmës ekonomike dhe përdorimit të fondit shtesë mbi fondin e kushtëzuar për ndihmën ekonomike” dhe në kriteret e miratuara nga këshilli i Bashkisë

Roskovec në Vendimin nr.3, datë 30.01.2024,"Për miratimin e kriterëve për familjet në nevojë që do të trajtohen me ndihmë ekonomike, nga fondi i kushtëzuar deri 6% për bllok-ndihmën për vitin 2024".

Konceptoi: *S.Saliaj*

Miratoi: *S.Çepele*



KRYETAR

Majlinda BUFI





REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA ROSKOVEC
DREJTORIA E SHËRBIMEVE SOCIALE DHE KULTURORE

Nr. 528 prot

Roskovec , më 23.01 .2025

PROJEKT-VENDIM

Nr. 3 datë 23/01 /2025

**PËR MIRATIMIN E KRITEREVE PËR FAMILJET NË NEVOJË QË DO TË
TRAJTOHEN ME NDIHMË EKONOMIKE, NGA FONDI I KUSHTËZUAR
DERI 6% PËR BLOK-NDIHMËN PËR VITIN 2025**

Në mbështetje ligjit nr. 139, datë 17.12.2015 “ Për vetë qeverisjen vendore”, ligji nr. 9936, date 26.06.2008 “ Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë” i ndryshuar. Nenit 21 të Ligjit nr. 57/2019, “Për Asistencën Sociale në Republikën e Shqipërisë”, në pikën 1, të Kreut IV të Vendimit nr. 597, datë 04.09.2019 “Për përcaktimin e procedurave, të dokumentacionit dhe masës mujore të përfitimit të ndihmës ekonomike dhe përdorimit të fondit shtesë mbi fondin e kushtëzuar për ndihmën ekonomike”i ndryshuar.

Spektori i ndihmës ekonomike ju paraqet për diskutim dhe miratim Këshillit të Bashkisë Roskovec kriteret e mëposhtëme për trajtimin e familjeve që nuk janë përfituese nga sistemi i pikëzimit, për vitin 2025.

- Familjet të cilat kanë aplikuar për ndihmë ekonomike brënda tre muajëve të fundit dhe nuk janë përzgjedhur fitues nga sistemi i pikëzimit.
- Familjet të cilat përzgjidhen për tu trajtuar me këtë fond duhet të jenë verifikuar paraprakisht nga zyra e ndihmës ekonomike.
- Familjet e përzgjedhura duhet të jenë familje në nevoj , të jenë pa të ardhura ose me të ardhura të pamjaftueshme.

- Familjet ku kryefamiljari ose dhe anëtarë të tjerë madhorë, të cilët janë të paaftë për punë por për shkak të legjislacionit në fuqi nuk përfitojnë pagesën e paaftësisë.
- Familjet me prindër të divorcuar me të paktën një fëmijë në arsimin bazë ose të lartë.
- Familjet me kryefamiljar vajzat nëna dhe grate e veja.
- Familjet të cilat nuk kanë anëtar përfitues të pensionit të pleqëris.

Pas miratimit nga Këshilli i Bashkisë Roskovec, ngarkohet sektori i Shërbimit Social për ekzekutimin e këtij vendimi.

P.Z. SHËRBIMIT SOCIAL


Sidorela Saliaj 

Dr.Shërbimit Social.S.Çepele



KRYETAR

Majlinda Bufi





REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA ROSKOVEC
DREJTORIA E SHËRBIMEVE SOCIALE DHE KULTURORE

Nr. 528/1 prot

Roskovec , më 23.01 .2025

Relacion: Për miratimin e kritereve për familjet në nevojë që do të trajtohen me ndihmë ekonomike, nga fondi i kushtëzuar deri 6% për bllok-ndihmën për vitin 2025

KËSHILLIT TË BASHKISË

Roskovec

Të nderuar Këshilltarë!

Në bazë të nenit 21 të Ligjit nr. 57/2019, “Për Asistencën Sociale në Republikën e Shqipërisë”, Këshilli bashkiak miraton kriteret për dhënien e ndihmës ekonomike për familjet aplikuese, të cilat nuk janë shpallur përfituese nga sistemi i pikëzimit, bazuar në vlerësimin sociale-konominik të kryer nga administratori shoqëror. Familjet në nevojë trajtohen nga fondi shtesë mbi fondin e kushtëzuar për ndihmën ekonomike, duke përfshirë ose jo edhe fonde të buxhetit vendor. Përdorimi i fondit shtesë mbi fondin e kushtëzuar për ndihmën ekonomike përcaktohet me vendim të Këshillit të Ministrave, në pikën 1, të Kreut IV të Vendimit nr. 597, datë 04.09.2019 “Për përcaktimin e procedurave, të dokumentacionit dhe masës mujore të përfitimit të ndihmës ekonomike dhe përdorimit të fondit shtesë mbi fondin e kushtëzuar për ndihmën ekonomike”, Këshilli bashkiak miraton në fillim të vitit kriteret për dhënien e ndihmës ekonomike për familjet aplikuese për ndihmë ekonomike, të cilat nuk janë shpallur fituese nga sistemi i pikëzimit dhe që do të trajtohen me fondin shtesë mbi fondin e kushtëzuar për ndihmën ekonomike.

Spektori i ndihmës ekonomike ju paraqet për diskutim dhe miratim Projekt-Vendimin “Për miratimin e kritereve për familjet në nevojë që do të trajtohen me ndihmë ekonomike, nga fondi i kushtëzuar deri 6% për bllok-ndihmën për vitin 2025” me kriteret e mëposhtëme, për trajtimin e familjeve që nuk janë përfituese nga sistemi i pikëzimit, për vitin 2025.

- Familjet të cilat kanë aplikuar për ndihmë ekonomike brënda tre muajëve të fundit dhe nuk janë përzgjedhur fitues nga sistemi i pikëzimit.

- Familjet të cilat përzgjidhen për tu trajtuar me këtë fond duhet të jenë verifikuar paraprakisht nga zyra e ndihmës ekonomike.
- Familjet e përzgjedhura duhet të jenë familje në nevoj , të jenë pa të ardhura ose me të ardhura të pamjaftueshme.
- Familjet ku kryefamiljari ose dhe anëtarë të tjerë madhorë, të cilët janë të paaftë për punë por për shkak të legjislacionit në fuqi nuk përfitojnë pagesën e paafhtësisë.
- Familjet me prindër të divorcuar me të paktën një fëmijë në arsimin bazë ose të lartë.
- Familjet me kryefamiljar vajzat nëna dhe grate e veja.
- Familjet të cilat nuk kanë anëtar përfitues të pensionit të pleqëris.

Këto kritere do i shërbejnë administratorëve social të Bashkisë Roskovec për të përzgjedhur familjet më në nevoj, të cilat kanë aplikuar dhe nuk janë shpallur fituese nga sistemi i pikësimit, për ti propozuar për trajtim nga fondi deri 6% dhe do të miratohen nga Këshilli i Bashkisë Roskovec çdo muaj.

P.Z. SHËRBIMIT SOCIAL
Sidorela Saliaj 

Dr.Shërbimit Social.S.Çepele



KRYETAR
Majlinda Bufi





REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA ROSKOVEC
DREJTORIA E INTEGRIMIT EUROPIAN

Nr. 29 Prot

Roskovec, më 23.01.2025

PROJEKT – VENDIM

NR. 4 DATË 23.01 2025

PËR

“MIRATIMIN E KËSHILLIT EKONOMIK NË BASHKINË ROSKOVEC”

Në mbështetje dhe zbatim të ligjit nr. 139/2015 "Për Vetëqeverisjen Vendore", Neni 54, pika k “*Miraton norma, standarde e kriteret për rregullimin dhe disiplinimin e funksioneve që i janë dhënë atij me ligj, si dhe për mbrojtjen e garantimin e interesit public*” si dhe me propozim të kryetarit të bashkisë, me qëllim zhvillimin e një procesi të vazhdueshëm të dialogut publik-privat (DPP) për përmirësimin e mjedisit të biznesit lokal dhe zbatimin e iniciativave lokale.

JU PARAQESIM PËR DISKUTIM DHE MIRATIM :

1- Krijimin e Këshilli Ekonomik në Bashkinë Roskovec të përbërë nga:

1. Olta Goga - Subjekt privat
2. Ervin Sopiku - Subjekt privat
3. Klodian Selamaj - Subjekt privat
4. Lulzim Dulla - Subjekt privat
5. Teuta Pirra - Subjekt privat
6. Genci Agaci - Subjekt privat
7. Mitat Hoxha - Subjekt privat
8. Ronada Hoxha - Drejtor Ekzekutiv, OJF
9. Orgesa Goga - Drejtor i Zhvillimi Ekonomik
10. Selman Cepele - Drejtor Ekonomik

11. Eneida Hoxha - Drejtor i Planifikimit Zhvillimit të Territorit, Mjedisit dhe
Pronës

Pas miratimit nga Këshilli Bashkiak ngarkohet Drejtoria e Integritimit Europian dhe
Drejtoria e Zhvillimit Ekonomik për ekzekutimin e ketij vendimi.

Konceptoi: E. Shehu

Për Drejtorin e Burimeve Njerëzore dhe Cështjeve Juridike: V. Zeqo

KRYETAR
Majlinda Bufi





REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA ROSKOVEC
DREJTORIA E INTEGRIMIT EUROPIAN

Nr. 529/1 Prot

Roskovec, më 23.01.2024

Lënda: Relacion për themelimin e Këshillit Ekonomik në Bashkinë Roskovec

KËSHILLIT BASHKIAK

Këtu,

Të nderuar !

Në mbështetje dhe zbatim të ligjit nr. 139/2015 "Për Vetëqeverisjen Vendore", Neni 54, pika k "Miraton norma, standarde e kritere për rregullimin dhe disiplinimin e funksioneve që i janë dhënë atij me ligj, si dhe për mbrojtjen e garantimin e interesit public" si dhe me propozim të kryetarit të bashkisë, ju paraqesim për diskutim dhe miratim krijimin e Këshilli Ekonomik me qëllim zhvillimin e një procesi të vazhdueshëm të dialogut publik-privat (DPP).

Vizioni i Bashkisë Roskovec synon ndërtimin e një komuniteti lokal me infrastrukturë të zhvilluar sipërmarrëse, kushte të favorshme për investitorët, zhvillimin e turizmit, bujqësisë, sipërmarrjes së vogël dhe të mesme, si dhe infrastrukturës komunale. Gjithashtu, mbrojtja e mjedisit është prioritet për të krijuar një mjedis tërheqës ekonomikisht dhe shoqëror për jetesë dhe zhvillim.

Për të arritur këtë vizion, Bashkia Roskovec do të përfshijë të gjitha grupet e interesit, institucionet dhe individët në mënyra të ndryshme të bashkëpunimit. Me miratimin e Këshillit Ekonomik, do të organizohen konferenca, tryeza të rrumbullakëta dhe takime ekspertësh mbi çështje që lidhen me përmirësimin e zhvillimit ekonomik lokal. Ky këshill do të përcaktojë rregullat e punës përmes aktit të tij themelues.

Roli dhe funksioni i Këshillit Ekonomik:

Këshilli Ekonomik është një organ këshillimor, që jep mendime, rekomandime dhe iniciacione për çështje që lidhen me gjendjen e ekonomisë dhe masat për përmirësimin e zhvillimit ekonomik lokal.

Disa nga veprimtaritë e Këshillit Ekonomik përfshijnë:

- Organizimin e konferencave dhe sesioneve tematike ku marrin pjesë subjektet afariste të regjistruara në Bashkinë Roskovec ;
- Koordinimin e punës mes organeve të vetëqeverisjes vendore dhe subjekteve afariste;
- Pjesëmarrjen në hartimin e strategjive dhe akteve që përcaktojnë objektivat dhe masat për përmirësimin e zhvillimit ekonomik lokal;
- Dhënien e rekomandimeve gjatë përgatitjes së buxhetit të Bashkisë Roskovec, për pjesët që lidhen me zhvillimin ekonomik lokal.

- Monitoron dhe merr pjesë në aktivitete që synojnë promovimin e Bashkisë Roskovec dhe potencialit të saj ekonomik;
- Organizon punën e bordit si organe të ngushta profesionale për veprimtari ekonomike, me rol konsultativ për përmirësimin e veprimtarive ekonomike;
- Ndërmerr iniciativa për përmirësimin e mjedisit të biznesit dhe heqjen e barrierave administrative;
- Bashkëpunon me organe të njëjta ose të ngjashme të komunave dhe qyteteve të tjera, si dhe me organe dhe institucione republikane dhe shtetërore, për shkëmbimin e përvojave dhe forcimin e bashkëpunimit ekonomik;
- Ndërmerr iniciativa për përmirësimin e bashkëpunimit mes autoriteteve, institucioneve, shërbimeve dhe kompanive publike të themeluara nga Bashkia e Roskovec, si dhe subjekteve ekonomike dhe autoriteteve republikane, organizatave dhe institucioneve në zonën e Bashkisë Roskovec ;
- Shqyrton çështje që përfshijnë masa dhe aktivitete për krijimin e kushteve më të mira për zhvillimin ekonomik.

Duke marrë shkas nga nevoja e Bashkisë për të krijuar një strategji afatgjatë që siguron stabilitetin e mjedisit ekonomik ekzistues dhe përmirësimin e cilësisë së shërbimeve vendore, është e nevojshme miratimi i Këshillit Ekonomik. Ky këshill ndihmon në përmirësimin e bashkëpunimit me bizneset që ofrojnë shërbime në qytet.

Këshilli Ekonomik mund të kuptohet edhe si një proces sistematik që parashikon dhe vlerëson efektet e mundshme mjedisore gjatë hartimit të një programi, me qëllim adresimin e këtyre efekteve në mënyrë të përshtatshme.

Detyra e Këshillit Ekonomik është të sigurojë dhe përmirësojë dialogun publiko-privat përmes bashkëpunimit të drejtpërdrejtë të autoriteteve lokale, kryetarit të bashkisë dhe subjekteve. Ky këshill funksionon si organ me përfaqësim të barabartë, i përbërë nga:

- Përfaqësues të subjekteve të regjistruara në territorin e Bashkisë së Roskovec, të cilët merren me aktivitete të ndryshme ekonomike (prodhim, zëjtari-sipërmarrje, bujqësi, financa, shërbime etj.);
- Përfaqësues të autoriteteve të Bashkisë Roskovec.

Ky këshill do të kontribuojë në fuqizimin ekonomik të zonës dhe krijimin e një mjedisi më të favorshëm për të gjithë.

Konceptoi: E. Shehu

**KRYETAR
Majlinda Bufi**

Ne marrim pjesë dhe urdhërojmë

 ZV. KRYETAR
 MAKSIM BOGA



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA ROSKOVEC
DREJTORIA E PLANIFIKIMIT DHE ZHVILLIMIT TE TERRITORIT, MJEDISIT DHE
PRONES

Nr. 530 prot

Roskovec, më 23 / 01 / 2025

PROJEKT-VENDIM

NR 5 .DATE 23.01 .2025

“PËR MIRATIM TË PROJEKTEVE PRIORITETARE PËR BASHKINË ROSKOVEC ”

Mbështetur në autoritetin e Kryetarit të Bashkisë Roskovec dhe në zbatim të Ligjit Nr. 139/2015, datë 17.12.2015 “Për Vetëqeverisjen Vendore”, i ndryshuar, neni 29,
Në zbatim të nenit 16, të Ligjit nr. 8756, dt. 26.03.2001, “Për Emergjencat civile” ligjin **107/2014**, datë 31.07.2014 “Për planifikimin dhe zhvillimin e territorit”, i ndryshuar neni 12 dhe neni 13, dhe **VKM nr 686**, date **22.11.2017**,”Per miratimin e rregullores se planifikimit te territorit”,

Ju paraqesim per diskutim e miratim,

1. Projektet prioritare të cilat kanë nevoj për ndërhyrje emergjente. që kanë të dalë pas kontrolleve në terren të grupit teknik të Bashkisë Roskovec dhe ekspertëve të jashtëm në periudha të ndryshme të vitit si dhe nga eksperiencat e mëparshme të fatkeqësive natyrore, për realizim projekti, për financim apo për zbatim projekti i bashkëlidhet projekt-vendimi.
2. Ngarkohet për zbatim Drejtoria e Planifikimit dhe Zhvillimit të Territorit ,Mjedisit dhe Pronave (DPZHTMP)

Konceptoi: A.Hoxha

Miratoi: E.Hoxha

Konfirmoi : D.Hoxha

(Sasia e ekzemplarëve të shtypur 3(tre))

KRYETAR
Majlinda Bufi

Lista e projekteve prioritare:

- 1- “Rikonstrukcion i objektit ekzistues të shkollës 9 - vjeçare “Ali Sollaku” dhe i ambjenteve sportive, Ndërtimi i shkallëve të emergjencës dhe Godina e Re e Palestrës së kësaj shkolle” në fshatin Vidhisht, Bashkia Roskovec”.
- 2- Riparim I shtresave sipërfaqësore të rrugëve në Qytetin Roskovec
- 3- Riparim I shtresave sipërfaqësore të rrugëve në NJA Kurjan
- 4- Riparim I shtresave sipërfaqësore të rrugëve në NJA Kuman
- 5- Riparim I shtresave sipërfaqësore të rrugëve në NJA Strum
- 6- Ndërtimi i unazës Perëndimore (e cila ka 3 nënobjekte)
 - Ndërtimi i tregut agro-ushqimor
 - Terminali i autobusave ndërqytetas
 - Rrugët lidhëse
- 7- “Rritja e sigurisë dhe përmirësimi I aftësisë ujëmbledhëse në rezervuarin e Kurjanit , Bashkia Roskovec”
- 8- “Rehabilitimi dhe rritja e sigurisë në digën e cervenit dhe rindërtimi i barazhit e mbrojtje nga grryerjet e përroit të buallit, lagjja Stan, njësia administrative Kurjan”
- 9- Ndërtimi I kopshtit dhe cerdhes Suk1
- 10- Marrja e masave për transferimin e banorëve të zonës së shkarjes Mbërs.
- 11- Rehabilitimi Urban i një pjese të bllokut nr. 3 në qendër të qytetit Roskovec, (faza I), me keto nenobjekte:
 - Ndërtimi i fushës së sportit me njësi tregëtare
 - Ndërtimi i parkut të ri të qytetit
 - Sistemimi i kanalit kullues dhe ndërtimi i rrugës lidhëse mbi të
 - Ndërtimi i Postës së re të Policisë (Projekt ekzistues i miratuar nga Bashkia Roskovec)
- 12- Rikonstrukcioni i ujësjellësit të Njesisë Administrative Kuman
- 13- Ndërtim i ujsellësit të fshatit Ngjeqar, Njësia Administrative Kurjan.
- 14- Rikualifikim urban i qëndrave të fshatrave.
- 15- Sistemi fotovoltaik për vetkonsum në stacionet e pompimit Arapaj, Metushaj, Jagodinë.
- 16- Sistem fotovoltaik për ngrohje në godinat e arsimin parauniversitar.
- 17- Rijetezim i ambjenteve sportive në territorin e Bashkisë Roskovec.
- 18- Linjë përpunimi të perimeve të fushës dhe përpunim i produktit ndryshe.
- 19- Rritja e sigurisë së digës dhe përmirësimi i ujitjes në rezervuarin e Kurjanit.
- 20- Përmirësimi i ujitjes në fshatin Suk 1,
- 21- Rehabilitimi i përroit të Vidhishtës (përgjat fshatit),
- 22- Njësi përpunimi, grumbullimi, laborator dhe markimi i vajit të ullirit.

- 23- Linja e përpunimit të produktit ndryshe
- 24- Rivitalizimi i pyllit të Luarit dhe parkut rekreativ
- 25- Krijimi I shtegut i bicikletave
- 26- Rikonstruksioni total i kishës së Shën Gjergjit (Monument kulture)
- 27- Pyllëzimim e liqenit të Kurjanit
- 28- Pyllëzimi i brezit të gjelbër, Suk-Jagodinë- Marinëz.
- 29- Krijimi i parkut zero karbon.
- 30- Sistemi I ndricimit rrugor me energji të rinovueshme

Konceptoi: *A.Hoxha*

Miratoi: *E.Hoxha*

Konfirmoi : *D.Hoxha*

(Sasia e ekzemplarëve të shtypur 3(tre))



KRYETAR
Majlinda Bufi





REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA ROSKOVEC
DREJTORIA E PLANIFIKIMIT DHE ZHVILLIMIT TË TERRITORIT, MJEDISIT
DHE PRONAVE

Nr. 330/4 prot

Roskovec, më 23.04.2025

RELACION

Lënda : Mbi “Miratimin e projekteve prioritare për Bashkinë Roskovec për vitin 2025”

Bashkia Roskovec , Drejtoria e Planifikimit dhe Zhvillimit Të Territorit, gjatë verifikimeve në terren në periudha të ndryshme të vitit 2023 ka nxjerrë listën e projekteve prioritare. Projektet janë bazuar nga nevojat emergjente të fatkeqsive natyrore, nevojat emergjente të restaurimeve të godinave arsimore, projekteve inovatore të energjisë së rinovueshme, menaxhimit të mbetjeve dhe projektet e pyllëzim-gjelberimit si edhe rikualifikimit urban.

Projektet prioritare janë si më poshtë:

Projekte Infrastruktura:

- 1- “Rikonstruksion i objektit ekzistues të shkollës 9 - vjeçare “Ali Sollaku” dhe i ambjentëve sportive, Ndërtimi i shkollëve të emergjencës dhe Godina e Re e Palestrës së kësaj shkolle” në fshatin Vidhisht, Bashkia Roskovec”.
- 2- Riparim I shtresave sipërfaqësore të rrugëve në Qytetin Roskovec
- 3- Riparim I shtresave sipërfaqësore të rrugëve në NJA Kurjan
- 4- Riparim I shtresave sipërfaqësore të rrugëve në NJA Kuman
- 5- Riparim I shtresave sipërfaqësore të rrugëve në NJA Strum
- 6- Ndërtimi i unazës Perëndimore (e cila ka 3 nënobjekte)
 - Ndërtimi i tregut agro-ushqimor
 - Terminali i autobusave ndërqytetas
 - Rrugët lidhëse
- 7- “Rritja e sigurisë dhe përmirësimi I aftësisë ujëmbledhëse në rezervuarin e Kurjanit , Bashkia Roskovec”

- 8- "Rehabilitimi dhe rritja e sigurise në digën e cervenit dhe rindërtimi i barazhit e mbrojtje nga grryerjet e përroit të buallit, lagjja Stan, njësia administrative Kurjan"
- 9- Ndërtimi I kopshtit dhe cerdhes Suk1
- 10- Marrja e masave për transferimin e banorëve të zonës së shkarjes Mbërs.
- 11- Rehabilitimi Urban i një pjese të bllokut nr. 3 në qendër të qytetit Roskovec, (faza I), me keto nenobjekte:
- Ndërtimi i fushës së sportit me njësi tregëtare
 - Ndërtimi i parkut të ri të qytetit
 - Sistemimi i kanalit kullues dhe ndërtimi i rrugës lidhëse mbi të
 - Ndërtimi i Postës së re të Policisë (Projekt ekzistues i miratuar nga Bashkia Roskovec)
- 12- Rikonstruksioni i ujësjellësit të Njësisë Administrative Kuman
- 13- Ndërtim i ujsellësit të fshatit Ngjeqar, Njësia Administrative Kurjan.
- 14- Rikualifikim urban i qendrave të fshatrave.
- 15- Sistemi fotovoltaik për vetkonsum në stacionet e pompimit Arapaj, Metushaj, Jagodinë.
- 16- Sistem fotovoltaik për ngrohje në godinat e arsimin parauniversitar.
- 17- Rijetëzim i ambienteve sportive në territorin e Bashkisë Roskovec.
- 18- Linjë përpunimi të perimeve të fushës dhe përpunim i produktit ndryshe.
- 19- Rritja e sigurisë së digës dhe përmirësimi i ujitjes në rezervuarin e Kurjanit.
- 20- Përmirësimi i ujitjes në fshatin Suk 1,
- 21- Rehabilitimi i përroit të Vidhishtës (përgjat fshatit),
- 22- Njësi përpunimi, grumbullimi, laborator dhe markimi i vajit të ullirit.
- 23- Linja e përpunimit të produktit ndryshe
- 24- Rivitalizimi i pyllit të Luarit dhe parkut rekreativ
- 25- Krijimi I shtegut i bicikletave
- 26- Rikonstruksioni total i kishës së Shën Gjergjit (Monument kulture)
- 27- Pyllëzimim e liqenit të Kurjanit
- 28- Pyllëzimi i brezit të gjelbër, Suk-Jagodinë- Marinëz.
- 29- Krijimi i parkut zero karbon.
- 30- Sistemi I ndricimit rrugor me energji të rinovueshme

Konceptoi: A.Hoxha

Miratoi: E.Hoxha

Konfirmoi : D.Hoxha

Sasia e ekzemplarëve të shtypur: 3 (tre)

KRYETAR
Majlinda Buri



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA ROSKOVEC

Nr. 531 Prot.

Roskovec, më 23.01 2025

PROJEKT-VENDIM

Nr. 6 datë 23.01 /2025

PËR

**MIRATIMIN E NDIHMËS NGA FONDI KUSHTËZUAR PËR DJEGIEN E BANESËS SË Z.
SHPËTIM KUQO, NË FSHATIN VIDHISHT, NJËSIA ADMINISTRATIVE KUMAN,
BASHKIA ROSKOVEC PËR VITIN 2025”**

Në mbështetje të nenit 8 pika 2 të Ligjit 139/2015 datë 19.12.2015 “Për vetëqeverisjen vendore”, të ndryshuar; Ligjit Nr.45/2019, datë 18.07.2019 “Për mbrojtjen civile”; VKM Nr. 329, datë 16.05.2012 “Për kriteret dhe procedurat e dhënies së ndihmës shtetërore financiare për mbulimin e dëmeve të shkaktuara nga fatkeqësi natyrore ose fatkeqësi të tjera të shkaktuara nga veprimtaria njerëzore”, si dhe shkresës Nr.174 prot, datë 13.01.2025 të Sektorit të Zbatueshmërisë së Investimeve të Bashkisë Roskovec, Kërkesës Nr. 193 prot datë 14.01.2025 për dëmshpërblim,

Ju paraqesim diskutim dhe miratim :

1. Miratimin e vlerës financiare të dëmeve të shkaktuara nga djegia në banesën e Z.Shpëtim Kuqo, ndodhur në fshatin Vidhisht, Njësia Administrative Kuman, Bashkia Roskovec. Sipas preventivit të hartuar përkatësisht në masën 215,842 lekë.
2. Shpërblimi financiar do të përballohet nga Fondi i Emergjencave Civile të Bashkisë Roskovec.
3. Ngarkohet Administrata e Bashkisë për zbatimin e këtij vendimi.

Konceptoi: S.Çepele

Konfirmoi: D.Hoxha

Sasia e ekzemplarëve të shtypur: 3(tre)

KRYETAR
Majlinda Bufi



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA ROSKOVEC

Nr. 531/1 prot.

Roskovec, më 23.01.2025

Lënda: Relacion për Projekt-Vendimin "Për miratim të ndihmës nga fondi kushtëzuar për djegien e banesës së Shpetim Kuqo, Bashkia Roskovec për vitin 2025"

KËSHILLIT BASHKIAK ROSKOVEC

Roskovec

Në Bashkinë Roskovec është depozituar Kërkesa Nr. 193 prot datë 14.01.2025 nga Z. Shpetim Kuqo kukërkon dëmshpërblim për banesën e djegur nga zjarri, Shkresa Nr. 174 prot datë 13.01.2025 i Sektorit të Zbatueshmërisë dhe Investimeve dhe Fletë Njoftimi datë 13.01.2025 lidhja XIII, Raport datë 13.01.2025 lidhja XIV të M.Z.SH-së Roskovec. Nga Kryetari i Bashkisë është ngritur Urdhër Nr. 11 datë 15.01.2025 "Për ngritjen e komisionit për verifikimin dhe vlerësimin e dëmeve të shkaktuara nga zjarri i rënë datë 13.01.2025 në "Fshatin Vidhisht", Njesia Administrative Kuman, Bashkia Roskovec.

Komisioni shkoi në banesën e Z. Shpetim Kuqo për të konstatuar dëmet e shkaktuara nga rënia e zjarrit. Mbas konstatimit të gjendjes së banesës është bërë preventivi i vlerësimit të dëmeve nga Sektori i Zbatueshmërisë së Investimeve të Bashkisë Roskovec përkatësisht në masën 215,842 (Dyqind e pesëmbëdhjete mije e teteqind e dyzete e dy). Aktualisht Bashkia Roskovec ka mundësi financiare për të ndihmuar Z. Shpetim Kuqo për banesën e djegur.

Për sa më lart i kërkojmë Këshillit të Bashkisë Roskovec të miratojë vlerën financiare të dëmeve të shkaktuara nga djegia në banesën e z. Shpetim Kuqo në datën 13.01.2025 sipas preventivit të hartuar nga Sektori i Zbatueshmërisë së Investimeve të Bashkisë Roskovec në masën 215,842 (Dyqind e pesëmbëdhjete mije e teteqind e dyzete e dy) i cili do të përballohet nga fondi i Emergjencave Civile të Bashkisë Roskovec.

Vendimmarrja që i kërkohet Këshillit të Bashkisë Roskovec, gjen mbështetje ligjore në zbatim të ligjit nr. 139/2015 "Për vetë qeverisjen vendore" neni 8 pika 2, neni 9/1 pika b, neni 29/1, të ligjit nr. 45/2019 "Për mbrojtjen civile", në VKM Nr. 329 data 16.05.2012 "Për kriteret dhe procedurat e dhënies së ndihmës shtetërore financiare për mbulimin e dëmeve të shkaktuara nga fatkeqësi natyrore ose fatkeqësi të tjera të shkaktuara nga veprimtaria njerëzore" paragrafi III/ë dhe pika 3/b.

Në përfundim, i kërkojmë Këshillit të Bashkisë Roskovec:

- **Miratimin e Projekt-Vendimit "Për miratim të ndihmës nga fondi kushtëzuar për djegien e banesës së Shpetim Kuqo, Bashkia Roskovec për vitin 2025".**

Duke ju falenderuar për bashkëpunimin,

Konceptoi: S. Çepele

Konfirmoi: D. Hoxha

Sasia e ekzemplarëve të shtypur: 3 (tre)

KRYETAR
Majlinda Bufi



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA ROSKOVEC
SEKTORI ZBATUESHMERIA E INVESTIMEVE

Nr. 532 Prof.
dt. 23.01.2025

PROJEKT-VENDIM
NR 7 .DATË 23.01.2025

“PËR MIRATIMI E STRATEGJISE VENDORE PER ZVOGELIMIN E RISKUT NGA FATKEQESITE DHE PLANI I VEPRIMIT 2025-2030 ”.

Në mbështetje të ligjit nr.139, datë 17.12.2015 “Për Vetëqeverisjen Vendore” i ndryshuar, nenit 54, shkronja “k” dhe bazuar në ligjin nr.45, datë 18.07.2019, “Për Mbrojtjen Civile”, nenit 11.

Ju paraqesim për diskutim e miratim,

1. Dokumentin “E strategjisë vendore për zvogëlimin e riskut nga fatkeqësitë dhe plani I veprimit 2025-2030”. Bashkia Roskovec, sipas materialit që i bashkëlidhet këtij projekti. Si një detyrim ligjor, i cili ka për qëllim zvogëlimin dhe menaxhimin e fatkeqësive.
2. Dokumenti ”I strategjisë vendore për zvogëlimin e riskut nga fatkeqësitë dhe plani I veprimit 2025-2030”, do të zbatohet për periudhën kohore 2025-2030.
3. Pas miratimit ngarkohen për zbatim strukturat e bashkisë Roskovec.

Konceptoi: A. Toska

Miratoi: A. Dukaj

Sasia e ekzemplarëve të shtypur: 3 (tre)

KRYETAR
Majlinda Bufi

NË MUNGESË DHE ME URDHËR
ZËVENDËSKRYETAR
Maksim Goga





REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA ROSKOVEC
DREJTORIA E PLANIFIKIMIT DHE ZHVILLIMIT TE TERRITORIT

Nr. 523 prot

Roskovec. 23.01.2025

PROJEKT-VENDIM

NR 8. DATË 23.01.2025

“PËR MIRATIMIN E BASHKËFINANCIMIT PËR PROGRAMET E STREHIMIT
SOCIAL”

Në mbështetje të Ligjit Nr. 139/2015, datë 17.12.2015 "Për Vetëqeverisjen Vendore"i ndryshuar, të shkresës Nr.741 prot. datë 12.01.2024 "Mbi Fondet për programet e strehimit 2024" të Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë; Udhëzimit Nr.31, datë 18.11.2019, "Për Procedurat standarte të aplikimit dhe kriteret për përfitimin e fondeve nga buxheti i shtetit për programet e strehimit" referuar Ligjit nr. 22/2018 "Për strehimin social" të ndryshuar,

Ju paraqesim per diskutim dhe miratim:

1- Miratimin e bashkëfinancimit prej 50% për programin:

Përmirësimi i kushteve të banimit për komunitete të varfra dhe të pafavorizuara për vitin 2025-2026, :

Vlera e plotë e projektit është: 9 999 860 lekë me TVSH, nga e cila 50% financohet nga Bashkia.

Bashkia Roskovec merr përsipër të financojë 50% të vlerës së plotë të projektit konkretisht 4 999 930 lekë me TVSH "Përmirësim i kushteve të banimit për komunitete të varfëra dhe të pafavorizuara".

2- Ngarkohet Komisioni i Strehimit për kryerjen e procedurave përkatëse dhe zbatimin e këtij vendimi.

Për Drejtorinë e Planifikimit dhe Zhvillimit të Territorit : *E. Hoxha*
Për Drejtorinë Juridike dhe Burimeve Njerëzore: *V. Zeqo*

KRYETAR
Majlinda Bufi

NË MUNGESË DHE ME URDHËR
ZËVENDËSKRYETAR
Maksim Goga



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA ROSKOVEC
DREJTORIA E PLANIFIKIMIT DHE ZHVILLIMIT TË TERRITORIT

Nr. 599/1 prot

Roskovec, më 23.01.2025

RELACION

Lënda : Mbi “MIRATIMIN E BASHKËFINANCIMIT, PËR PROGRAMET E
STREHIMIT SOCIAL”

”

Bashkia Roskovec , Drejtoria e Planifikimit dhe Zhvillimit Të Territorit, Drejtoria Juridike, Sektori I Strehimit kanë aplikuar për të 8(tetë) vit radhazi në programin “Përmirësimi i kushteve të banimit për komunitetet e varfëra dhe të pafavorizuara”, thirrje e Ministrisë së Ekonomisë dhe Financave nga ku ka qënë fituese për disa vite.

Në aplikimin e vitit 2025 kërkohet që bashkëfinancimi të kaloj me Vendim Të Këshillit Bashkiak. **Bashkia Roskovec merr përsipër të financojë 50% të vlerës së plotë të projektit “ Përmirësim i kushteve të banimit për komunitete të varfëra dhe të pafavorizuara”**

Vlera e plotë e projektit është: 9 999 860 lekë me TVSH, nga e cila 50% financohet nga Bashkia Roskovec konkretisht 4 999 930 lekë me TVSH kjo vjen si rezultat I kushteve të bashkëfinancimit të këtij programi.

Konceptoi :*S.Plaka*

Miratoi : *E.Hoxha*

Konfirmoi: *D.Hoxha*

Sasia e ekzemplarëve të shtypur: 3 (tre)

KRYETAR

Majlinda Bufi

NË MUNGESË DHE ME URDHËR
ZËVENDËSKRYETAR
Maksim Goga





REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA ROSKOVEC
DREJTORIA E PLANIFIKIMIT DHE ZHVILLIMIT TE TERRITORIT

534
Nr. ___prot

Roskovec, 23.01.2025

PROJEKT-VENDIM

NR 9 . DATË 23.01.2025

“PËR MIRATIMIN E LISTËS SË PËRFITUESVE NGA PROGRAMI PËRMIRËSIMI I KUSHTEVE TË BANIMIT PËR KOMUNITETE TË VARFRA DHE TË PAFAVORIZUARA”

Në mbështetje të Ligjit Nr. 139/2015, datë 17.12.2015 “Për Vetëqeverisjes Vendore” i ndryshuar, neni 24; Ligjit nr. 22/2018 “Për strehimin social” Vkm-së nr. 454, datë 03.07.2019 “Për kriteret dhe procedurat e përfitimit e të dhënies sëgranteve konkurruese për përmirësimin e kushteve tëobjekteve dhe banesave ekzistuese”, Udhëzimit Nr. 31, datë 18.11.2019 “Për procedurat standarde të aplikimit dhe kriteret përpërfitimin e fondeve nga buxheti i shtetit për programet e strehimit”, Vendim nr. 384, datë 12.6.2019 “Për përcaktimin e dokumentacionit për të përfituar strehim sipas çdo programi social të strehimit dhe të afateve e të procedurave të miratimit nga organet e vetëqeverisjes vendore”,

Ju paraqesim per diskutim dhe miratim:

- 1- Miratimin e listës së përfituesve nga programi përmirësimi i kushteve të banimit për komunitete të varfra dhe të pafavorizuara për vitin 2025-2026, konkretisht:
- *Lista bashkëlidhur*
- 2- Ngarkohet Komisioni i Strehimit per kryerjen e procedurave perkatëse dhe zbatimin e këtij vendimi.

Për Drejtorinë e Planifikimit dhe Zhvillimit të Territorit : E. Hoxha
Për Drejtorinë Juridike dhe Burimeve Njerëzore: S.Kuka

KRYETAR
Majlinda Bufi

NË MUNGESË DHE ME URDHËR
ZËVENDËSKRYETAR

Maksim Goga

